




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-23082/20 datë:16.11.2020



Npi – 01/270 Datë: 24.11.2020

Duke u bazuar në nenin 12.2, pika (d) nenet 81 dhe 82 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës”, Qershor 2008); Kuvendi i Komunës së Shtimes, shqyrtoi kërkesën e Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, Nr. 020-777/5 datë: 27.10.2020, për Rishqyrtimin e Vendimit të Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01-211, Për zhvendosjen e pronës komunale. Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 24.11.2020, aprovoi këtë:

V E N D I M

PËR ANULIMIN E VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË SHTIMES
Npi – 01/211 TË DATËS: 29.09.2020

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -IX- të rregullt për vitin 2020, e mbajtur më 24.11.2020, me shumicën e votave vendosi të ANULOJË Vendimin e Kuvendit të Komunës së Shtimes, Npi-01/211, të datës: 29.09.2020, me të cilin aprovohet kërkesa Nr.01-070/05-6235/20 e datës: 09.03.2020, të z.Sali Beqaj nga fshati Petrovë, për Zhvendosjen e N. K. Nr.313/3, 313/4, 313/5 dhe 313/6, Z. K. – Davidovc, Evidentuar pronë e Sali Beqaj – Petrovë, me gjithsej sipërfaqe prej 1 hektar e 2 ari, (10.248m²), duke e zhvendosur me pronën e paluajtshme të Komunës së Shtimes, me sipërfaqen e barabartë në pjesën e N. K. Nr.333/4, Z. K. – Davidovc, Evidentuar Pasuri Shoqërore e Kuvendit Komunal – Shtime.

II

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë nga dita e regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për qeverisje lokale, si dhe publikimit në ueb. faqen e Komunës së Shtimes.

III

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Palëve, Drejtorisë, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj